

V E N D I M
Nr.79, datë 6.2.2003

**PËR PAGAT E PUNONJËSVE TË INSTITUTIT TË TRAJNIMIT TË ADMINISTRATËS
PUBLIKE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 18 dhe 29 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil” dhe të neneve 2 e 6 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, me propozimin e Ministrit të Shtetit pranë Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Struktura dhe niveli i pagës për punonjësit e Institutit të Trajnimit të Administratës Publike të jenë sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
 2. Paga e grupit (kolona 2) e lidhjes nr.1 – diplomë e shkollës së lartë është 9 000 (nëntë mijë) lekë.
 3. Shtesa për vjetërsi pune (kolona 3), jepet në masën 2 për qind pas çdo viti pune, deri në 25 vjet dhe llogaritet mbi pagën e grupit.
 4. Shtesa për kualifikim (kolona 4) është 0.
 5. Shtesa për pozicion është sipas kolonës 5, të lidhjes nr.1.
 6. Kategorizimi (kolona 1) brenda çdo klase të bëhet në përputhje me lidhjen nr.2, e cila, bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
 7. Punonjësit e tjerë, që nuk përfshihen në lidhjet nr.1 dhe nr.2 të këtij vendimi, paguhet sipas lidhjes II-4 “Nivelet e pagës sipas funksioneve në Këshillin e Ministrave”, dhe lidhjes II.M “Paga bazë, sipas klasave për punonjësit e ministrave, institucioneve të tjera qendrore, ATSH-së, prefekturave dhe shërbimit gjeologjik shqiptar”, të vendimit nr. 726, datë 21.12.2000 të Këshillit të Ministrave “Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore”, ndryshuar me vendimet përkatëse.
 8. Niveli i pagës për emërtesën sekretar/asistent/arkëtar barazohet me nivelin e pagës së punonjësit të kategorisë III-a, sipas lidhjes nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 9. Efektet financiare të përballohen nga buxheti i Këshillit të Ministrave.
 10. Të gjitha dispozitat që bien në kundërshtim me këtë vendim shfuqizohen.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2003.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Lidhja nr.1

Nivelet e pagës për punonjësit e institutit të trajnimit të administratës publike

Klasa	Paga mujore				
	Kategoritë	Paga individuale (paga bazë)			Shtesa e pozicionit
	1	2	3	4	5
		Paga e	Shtesa vjetore	Shtesa për	Shtesa për

		grupit (PG)	për vjetërsi (SHV)	kualifikim (SHK)	pozicion (SHP)
I	I-a	9.000	2%	0	90.000
II	II-a	9.000	2%	0	55.000
III	III-a	9.000	2%	0	30.000
III	III-b	9.000	2%	0	20.000

Lidhja nr.2

KLASIFIKIMI I VENDEVE TË PUNËS

Klasa I: Është niveli më i lartë i menaxhimit të një institucioni dhe ka përgjegjësi për hartimin e politikave në një fushë të caktuar dhe për arritjen e rezultateve të përcaktuara në këtë fushë.

Në këtë klasë bën pjesë:

I-a Drejtori i institutit të trajnimit

Klasa II: Bën të mundur koordinimin e mendimit dhe opsioneve të reja politike për një fushë të caktuar të specialitetit, zbatimin e politikave në këtë nivel, përgatitjen e propozimeve përfundimtare, të cilat duhen aprovuar nga niveli menaxhues më i lartë. Kjo klasë bën të mundur gjithashtu edhe zgjidhjen e problemeve komplekse që lidhen me menaxhimin e projekteve të mëdha ose sektorëve/njësive brenda institucionit.

Në këtë klasë bëjnë pjesë:

II-aTrajnerët e përhershëm, përgjegjës finance/koordinator

Klasa III: Kjo klasë merret me zbatimin e politikave ekzistuese, koordinimin e aktiviteteve të stafit mbështetës, si dhe me formulimin dhe vlerësimin e opsioneve politike mbi një fushë të caktuar, duke u bazuar në eksperiencën profesionale të fushës, njohuritë e specialitetit, analizën e informacionit dhe kërkimin.

Në këtë klasë bëjnë pjesë:

III-aSpecialistë

III-bArkivistë